

Të gjeturat kryesore

Ligji mbi Edukimin Parashkollor (Nr. 02/L-52) është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 mars 2006, si pjesë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja nr. 2001/9 e datës 15. Maj 2001).

Për ta plotësuar ligjin, MASHT ka nxjerrur udhëzime administrative e ndër më esencjalët për funksionimin e institucioneve parashkollore janë trembdhjetë sosh. Këto dhe akte nënligjore që derivojnë nga ligji, rregullojnë në masë të madhe bazën ligjore në zbatimin sa më efikas të tij, por siç do të shtjellohet edhe në vijim, pjesë të caktuara të ligjit nuk janë objekt i zbatimit, duke shkaktuar kështu mangësi në rregullimin e edukimit parashkollor në vend.

Parimet bazë të përcaktuara në Ligj (neni 4) për edukimin në institucionet parashkollore janë:

Barazia;

Gjithëpërfshirja;

Demokracia;

Autonomia e personelit;

Profesionalizmi dhe përgjegjësia;

Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marr parasysh ndryshimet në mes të fëmijeve;

E drejta për të qenë ndryshe;

Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve.